

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e vet, si Agjencia e Pagesave, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, si dhe sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar.

AZHBR është e organizuar në formën e një personi juridik publik në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

Funksionet dhe detyrat e Autoritetit Përgjegjës:

- **Funksionet:**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

- a) Fondeve të buxhetit të shtetit;
- b) Fondeve kundërpartit, të projektit 2KR;
- c) Fondeve të Bashkimit Evropian;
- ç) Fondeve të siguruar nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.

- **Detyrat:**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka për detyrë:

- a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, nëpërmjet:
 - i) ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në seli dhe në terren;
 - ii) orientimit të veprimtarisë së fermerëve në përputhje me drejtimit e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
 - iii) zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme;
- b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- ç) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- d) të zbatojë masat e kontrollit dhe auditit të brendshëm;

dh) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;

e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.